

VENDIM
Nr. 617, datë 22.9.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 597, DATË 4.9.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË
DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHITESË MBI FONDIN E
KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 8, e 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 7, 8 dhe 9, fjalët “... 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... 9 900 (nëntë mijë e nëntëqind) lekë në muaj ...”.

b) Pas pikës 16 shtohen pikat 16/1, 16/2 dhe 16/3, me këtë përmbajtje:

“16/1. Gratë kryefamiljare, përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje të familjes deri në dy fëmijë të moshës nga 0 në 18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

16/2. Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar, dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike.

16/3. Anëtarët e familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.”.

c) Pikat 17 dhe 18 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“17. Masa e ndihmës ekonomike për familjet, që nuk përfitojnë sipas pikave 16/1, 16/2 dhe 16/3, të këtij kreu, rritet me dhjetë për qind më shumë të masës së pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes.

18. Masa e ndihmës ekonomike sipas pikave 16, 16/1, 16/2, 16/3 dhe 17, të këtij kreu, përllogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në masën e pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku